



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 77, datë 27.12.2007

**“PËR NJE SHITESË BURSASH NE VENDIMIN NR. 61, DATE 30.11.2007 PËR  
MIRATIM DHËNIE BURSE SHTETI, NXËNËSVE DHE STUDENTËVE, PËR  
VITIN SHKOLLOR 2007-2008”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, nenit 11, pika 3/a, nenit 12, pika 4, nenit 32, gërma n, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.568, datë 10.10.2007 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve në institucionet arsimore publike”, si dhe Planit bursave të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të miratoje nje shtese bursash ne piken 2 te Vendimit te Këshillit Bashkiak Nr. 61, datë 30.11.2007, nga 223 bursa në 226 bursa për nxenesit e konvikteve te shkollave të mesme të Tiranës, i cili ndryshon shpërndarjen e bursave në 2 konviktet e mëposhtme:
  - **Konvikti i Ekonomikut:**  
37 bursa gjithësej, nga të cilat 28 bursa të plota dhe 9 gjysëm bursa.  
Ndryshimi behet ne vitin e pestë: 10 bursa gjithsejt, nga te cilat 6 bursa të plota dhe 4 gjysmë burse.
  - **Konvikti i Gjuhëve të Huaja:**  
41 bursa gjithsej, 40 bursa të plota dhe 1 gjysëm burse.  
Ndryshimi behet ne vitin e katërt.: 14 bursa gjithsejt, nga te cilat 13 bursa të plota dhe 1 gjysëm burse,
2. Të miratojë për vitin shkollor 2007-2008, propozimin e Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave te Mesme, për te trajtuar me bursë nxënësit e mëposhtëm:
  - **Besmir Muj Papa**, Konvikti i Ekonomikut, viti i pestë, nga gjysem burse ne burse te plote.
  - **Valentina Ibrahim Meshi**, Konvikti i Gjuhëve te Huaja, viti i katert, bursë të plotë.
  - **Valmira Shaban Kurti**, Konvikti i Gjuhëve te Huaja, viti i katert, bursë te plotë.
  - **Mirela Nik Dema**, Konvikti i Gjuhëve te Huaja, viti i katert: bursë të plotë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përkujdesit Social.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sokol DERVISHAJ**

**KRYETAR**